



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AKADEMIA E SHKENCAVE  
KRYESIA

Tiranë, më 23.1.2024

Vendim nr. 12 datë 23.1.2024

**Për disa shtesa dhe ndryshime në Statutin e ASH**

Në zbatim të Ligjit nr. 69/2023 *Për disa shtesa e ndryshime në Ligjin 53/2019 sipërcituar, miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë më 21.7.2023;*

Në përputhje me vendimin qarkullues të Asamblesë nr. 1 datë 9.1.2024 për miratimin e një kapitulli shtesë në Statut *për institutet dhe qendrat kërkimore të përhershme;*

Referuar nenit 18 të Ligjit 53/2019 *Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë;*

Referuar VKM nr. 821 datë 28.12.2023 *Për ngritjen dhe organizimin e njësisive të përhershme të kërkim-studimit në albanologji pranë Akademisë së Shkencave në Republikën e Shqipërisë;*

Referuar propozimit të bërë në mbledhjen këshillimore të Kryesisë me drejtorët e instituteve të albanologjisë e kryetarët e komisioneve të përhershme, më datë 9.1.2024, për përshtatshmërinë e organizimit të komisioneve me ato të instituteve në fushën e albanologjisë;

Kryesia e Akademisë së Shkencave, në mbledhjen e datës 23.1.2024,

**Vendosi:**

1. Të reflektohen në Statut ndryshimet e bëra në ligjin 53/2019 me ligjin nr. 69/2023, datë 21.7.2023 i Kuvendit të Shqipërisë, *Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 53/2019 “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”*, konkretisht:
  - hiqet neni 10 i Statutit *anëtarët korrespondentë* (neni 1, 2, 4 i ligjit 69/2023);

- në nenin 21 hiqet togfjalëshi *por jo radhazi* (neni 3, pika 4 i ligjit 69/2023);
  - hiqet pika 2 në nenin 22 të Statutit (neni 5 i ligjit 69/2023);
2. Të pasqyrohen ndryshimet që vijnë me përfshirjen e Kreut VI *Institutet dhe qendrat kërkimore të përhershme*, të miratuar me vendim qarkullues të Asamblesë nr. 1, datë 9.1.2024 (nga neni 46 e në vazhdim);
  3. T'i kërkojë Asamblesë ndryshimin e *Aneksit 4 "Komisionet dhe emërtimi i tyre"* duke i reformuluar si më poshtë:
    - *komisioni i arkeologjisë*
    - *komisioni i historisë*
    - *komisioni i gjuhësisë dhe letërsisë*
    - *komisioni i antropologjisë dhe trashëgimisë kulturore*
    - *komisioni i arteve*
    - *komisioni i ekonomisë, shkencave sociale dhe juridike*
    - *komisioni i matematikës, informatikës*
    - *komisioni i fikës, kimisë*
    - *komisioni i inxhinierisë*
    - *komisioni i mjekësisë*
    - *komisioni i biologjisë, bujqësisë, veterinarisë*
  4. Këto ndryshime e Statuti i përditësuar e reformuluar sipas këtyre ndryshimeve t'i paraqitet për miratim Asamblesë (kopja bashkëngjitur).
  5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Akad. Skënder GJINUSHI

KRYETAR

